



RREGULLORE 05.

PËR ORGANIZIMIN E GARAVE, VENDORE DHE DERKOMBETARE  
Organizuar nga Federata e Peshkatarëve Sportiv Recreativ e Kosovës

Prishtine Korrik 2024

Në bazë të nenit 19 të Statutit të Federatës së Peshkatarëve Sportiv Recreativ të Kosovës në mbledhjen e mbajtur më..... Bordi i FPSRK-së propozon rregullore:

#### DRAFT RREGULLORE

#### PËR ORGANIZIMIN E GARAVE, VENDORE DHE DERKOMBETARE

##### Neni 1

Qëllimi i kësaj rregullore është të precizoj detajet e organizimit të garave nga **Federata e Peshkatarëve Sportiv Recreativ të Kosovës**.

##### Neni 2

Organizimet e garave ndahen në: **1. Federata e Peshkatarëve Sportiv Recreativ të Kosovës**, dhe **2. Organizimet e subjekteve të ndryshme në bashkëpunim me Federatën e Peshkatarëve Sportiv Recreativ të Kosovës**. Këtu përfshihen organizimet e garave nderkombetare.

##### Neni 3

Klubet e peshkimit dhe peshkatarët për t'u bërë anëtarë me të drejta të plota duhet më parë të regjistrohen në **Federatën e Peshkatarëve Sportiv Recreativ të Kosovës** (në tekstin e mëtejshëm: Federatë).

##### Neni 4

Peshkatarit/tjës mund të regjistrohet për secilin klub të peshkimit, sipas zgjedhjes ose dëshirës së tij/saj (duke veqar shoqatat). Çdo peshkatarë mund të regjistrohet vetëm për një klub peshkimi në Kosovë, përveç peshkatarëve të hendikepuar (shurdhmemecë, të verbër etj.), të cilët mund të jenë njëkohësisht edhe anëtarë të klubit të peshkimit të hendikepuarve, të verbërve, shurdhmemecëve apo formave tjera organizative brenda ombrellës së Federatës.

##### Neni 5

Peshkatarit që më parë nuk ka qenë anëtar i asnjë klubi, duhet të paraqes kërkesën për anëtarësim në klubin që dëshiron të regjistrohet. Kërkesa përmban këto shënime: - Emrin, emri i babës, mbiemri; - Data dhe vendi i lindjes; - Profesionin; - Adresën e banimit si dhe - Deklaratën nën betim se nuk është anëtar i asnjë klubi tjetër shahu.

##### Neni 6

Vetëm klubet dhe anëtarët (peshkatar) e regjistruar mund të marrin pjesë në garat kampionale të cilat i organizon Federata dhe në bazë të Rregullorës për kategorizim të fitojnë kategori ose tituj, si dhe mund të luajnë për klubin dhe qytetin e tyre, ose për përfaqësuesen e Kosovës.

##### Neni 7

Për t'u regjistruar një klub, ai duhet t'i paraqes Federatës këto dokumente: a) kërkesën për regjistrim si dhe emrin dhe adresën e klubit; b) deklaratën me shkrim të aplikuesit për zbatimin dhe respektimin e Statutit dhe akteve tjera juridike të FPSRK; c) certifikatën e OJQ-së nga Ministria e Administratës Publike dhe vërtetimi nga Drejtoria Komunale për Sport; d) një kopje të statutit dhe rregulloreve të saj, të cilat

duhet të jenë në pajtim me ligjin për sport dhe statutin e - FPSRK s; e) ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja themeluese e klubit ose nga kuvendi zgjedhor; f) emërat e personave të autorizuar për përfaqësim; g) listën e anëtarëve të kryesisë, kryetarit dhe sekretarit të klubit; h) listën e anëtarëve të klubit, i cili duhet të ketë më së paku 12 anëtarë dhe shënimet për ta, sipas nenit 3(tre), të kësaj Rregulloreje; i) të përmbushë detyrimet financiare që i përcakton Federata;

#### Neni 8

Çdo PESHKATAR duhet të paguaj antarësin vjetore në qe PERCAKTOHET cdo vit kalendarik në€. Peshkatarët e klubeve pagesën e bëjnë nëpërmjet klubeve, kurse peshkatart që nuk kanë klube pagesën e bëjnë në mënyrë direkte.

#### Neni 9

Organizimet e garave të FPSRK -së janë të gjitha garat që i organizon FPSRK -së. Pjesëmarrësit në këto gara duhet të bëjnë pagesat e kotizimit si në vijim:

- Kupa Individuale e Kosoves: -----5.00 €
- Kampionati Individual I Kosovës: ----- 0.00 €
- Kupa Ekipore e Kosovës: ----- 50.00 €
- Kotizimi për peshkatarve te huaj mbi : ----- 0.00 €
- Kotizimi për peshkatarve e huaj me perfundim : ----- 100.00 €

#### Neni 10

Të gjitha subjektet që organizojnë gara të peshkimit e që duan të shfrytëzojnë infrastrukturen e FSHK-së duhet që të bëjnë kontratë me Federatën-në së paku një javë para mbajtjen së garës dhe të paguajnë shumën sipas shpenzimeve te specifikuara:

- Infrastruktura e FPSRK -së përfshin: ....., transportin-----100.00 €
- Referët:-----50.00 €
- Ushqimi dhe shpenzimet tjera:-----50.00 € Pagesa bëhet me parapagim në xhirollogarin e Federates-së të specifikuar nga ana e saj.

#### Neni 11

Të gjitha garat e organizuar nga FPSRK -së ose nga subjektet tjera në bashkpunim me FSHK-në duhet të referohen nga refer që i cakton FPSRK -së në mënyrë rotative. Varësisht nga niveli organizimit, turniret mund ti referojnë edhe 2 (dy) e më shume referë. Pagesa për refer duhet të jetë 50.00 €.

#### Neni 12

Peshkatart dhe Selektori me ndihmësit e tij që marrin pjesë në gara nderkombetare duhet të paguhen me mëditje në vlerë 30.00 €. Kjo shumë mund të rritet varësisht nga sukcesi dhe gjendja financiare e FSHK-së.

#### Neni 13

Regjistrimi i klubeve dhe i shahistëve bëhet bazuar në planin vjetor i cili përgaditet nga kryesia e FSHeK-së në çdo fillim vitë kalendarik. Kryesia e - FPSRK së për çdo sezonë duke ju referuar planit vjetor të aktiviteteve i informon klubet për periudhën e regjistrimit dhe të afatit kalimtarë të shahistëve për vitin vijues.

#### Neni 14

Klubet e peshkimit kanë të drejtë të regjistrojnë edhe peshkatore jashtë Kosovës, por në një ndeshje nuk kanë të drejtë të luajnë më shumë se një (1) peshkatarve të jashtëm (nuk konsiderohen të jashtëm peshkatarve kosovarë që jetojnë, punojnë edhe në diasporë). Për çdo shahistë të jashtëm në regjistër, klubi është i detyruar që FPSRK-së t'i paguaj shumën sipas nenit 9.

#### Neni 15

Anëtari që regjistrohet për herë të parë, ka të drejtë loje në të gjitha garat prej ditës së regjistrimit.

#### Neni 16

Secili shahist i regjistruar duhet të posedojë librezën e anëtarësisë (të vërtetuar) të cilën e lëshon Federata.

#### Neni 17

Komisioni për regjistrim është i detyruar që të mbajë evidence të saktë për të gjitha klubet dhe anëtarët e regjistruar në Federatë dhe të raportoj në baza të rregullta.

Kjo Rregullore hyn në fuqi, shtatë (7) ditë pas nënshkrimit nga Kryetari i **Federata e Peshkatarëve Sportiv Recreativ e Kosovës** dhe publikimit në faqen zyrtare të FPSRK-së.

Milaim Vitić



Kryetar i Federata e Peshkatarëve Sportiv Recreativ e Kosovës